

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës
Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Moduli 2 - Lënda për
Ekspert të licensuar të
Forenzikës Financiare**

M2

ZGJIDHJET

Data 06.07.2019

1. Cila prej sa më poshtë mund të MOS konsiderohet simptom i mashtrimit:
 - A. Anomalitë në kontabilitet
 - B. Anomalitë analitike
 - C. Stili i jetesës**
 - D. Raportimet dhe ankesat

2. Cili prej sa më poshtë është mashtrim i zakonshëm me anomali:
 - A. Dokumente burimore te rregullta
 - B. Shënimet në libra
 - C. Dokumente të plota që shoqërojnë një transaksion
 - D. Ndërrimet e pashpjeguara në pasqyra financiare**

3. Dobësitë e kontrollit të brendshëm paraqiten në cilën si më poshtë:
 - A. Ndarja e detyrave mes punonjësve
 - B. Ekzistenca e masave mbrojtëse fizike
 - C. Sistem joadekuat kontabël**
 - D. Forcimi i kontrolleve ekzistuese

4. Cila nga këto është një teknikë e analizës së pasqyrave financiare që përfshin llogaritjen e ndryshimit të përqindjes në pasqyrën e të ardhurave ose zëra të bilancit nga një vit në tjetrin?
 - A. Mostra statistikore
 - B. Analiza horizontale**
 - C. Analiza e raportit
 - D. . Analiza vertikale

5. Cila prej më poshtë mund të konsiderohet si anomali analitike:
 - A. Mungesat apo korigjimet në inventar te dokumentuara nga punonjësit përkatës
 - B. Ndryshim i amortizimeve mbi bazën e politikës së aprovuar nga Bordi te asetëve të kompanisë
 - C. Blerje të tepërta**
 - D. Memorandume të debisë apo kredisë te shoqëruara me shpjegimet përkatëse

6. Në situatat e intervistimit, procesi i vëzhgimit të sjelljes para se të parashtrohet pyetja kritike quhet:
 - A. Normimi ose kalibrimi**
 - B. Vlerësimi
 - C. Analiza e mashtrimit
 - D. Asnjëra sa më lart

7. Fitore, një ekzaminuese e certifikuar e mashtrimit, po kryen një intervistë që synon pranimin nga Gramos, një i dyshuar për mashtrim. Fitore e pyet Gramosin: "A keni nevojë vetëm për para shtesë, apo a keni bërë këtë sepse keni pasur probleme financiare?" Kjo quhet një:
- A. Pyetja e racionalizimit
 - B. Pyetje alternative**
 - C. Pyetje e Standardit
 - D. Asnjëra sa më lart
8. Arsyet që punonjësit kryejnë mashtrime të deklaratave financiare përfshijnë cilat nga këto?
- A. Për të përmbushur qëllimet dhe objektivat e kompanisë
 - B. Për të marrë financime të reja ose për të marrë kushte më të favorshme për financimin ekzistues
 - C. Të demonstrojnë fitime në rritje për aksion, duke inkurajuar kështu rritjen e pagesave të dividendëve
 - D. Të gjitha sa më sipër**
9. Cila prej këtyre NUK është e saktë në lidhje me procesin e përcaktimit të objektivit të programit të menaxhimit të rrezikshmërisë së mashtrimit?
- A. Objektivat e hollësishëm të programit të menaxhimit të rrezikshmërisë së mashtrimit duhet të përshtaten me nevojat dhe qëllimet specifike të organizatës.
 - B. Menaxhmenti duhet të baraspeshojë investimin në kontrollet kundër mashtrimit me dobinë e atyre kontrolleve, si dhe sasinë e rreziqeve që ka vullnet të pranojë.
 - C. Menaxhmenti duhet të shikojë rastet e mëparshme të mashtrimit për të përcaktuar se si do të mund të parandaloheshin ato me një program ideal të menaxhimit të rrezikshmërisë së mashtrimit.**
 - D. Menaxhmenti duhet t'ia caktojë një masë kuantitative apetitit të tij për rrezikshmëri, ashtu që të mund të masë efektshmërinë e programit të menaxhimit të rrezikshmërisë së mashtrimit.
10. Besa, një ekzaminuese e certifikuar i mashtrimit, mori në interviste Taulantin, kontrollues i kompanisë XYZ. Besa e pyeti si me poshtë: "Duke qenë se ishit këtu kur u zhvilluan kontrollet, a mund të më thoni se si u bë kjo?" Kjo lloj pyetje quhet një _____.
- A. Teknika e përgjigjes së kontrolluar**
 - B. Pyetje negative
 - C. Pyetje komplekse
 - D. Asnjëra sa më lart
11. Të gjitha kushtet e mëposhtme janë të favorshme për raportim financiar mashtrues PËRVEÇ:
- A. Dominimi i menaxhimit nga një person i vetëm ose një grup i vogël
 - B. Transaksione relativisht të vogla ose balancat që janë lehtësisht të auditueshme**
 - C. Transaksione të rëndësishme dhe të pazakonta me palët e lidhura
 - D. Përdorimi i politikave kontabël tepër agresive në bazë të materialitetit

12. Shpend, një hetues i mashtrimit, po e zhvillon një intervistë me Valon. Ndonëse Shpend i dëgjoj të gjitha pyetjet gjatë pjesë hyrëse të intervistës, ai filloi ta pyes Valonin që t'i përsërit pothuajse çdo pyetje kur ata u fokusuan më shumë. Cilat nga zgjedhjet më poshtë është shkaku më i mundshëm i sjelljes së Valonit?
- Valoni e humb dëgjimin gjatë situatave stresuese
 - Valoni po e teston aftësinë e Shpendit për të parashtruar pyetje konsistente
 - Valoni po e vonon përgjigjen ashtu që ai ka më shumë kohë të mendoj se çfarë të thotë**
 - Asnjëra nga më lartë
13. Një Program Korporativ i Përputhshmërisë është i efektshëm kur ekziston:
- Standarde e procedura të vendosura për parandalim dhe zbulim të veprimeve kriminale
 - Autoriteti qeverisës duhet të mbikëqyrë programin e përputhshmërisë, person specifik i caktuar për t'u marrë me të në baza ditore
 - Mospërfshirja e asnjë individi për të cilin dihet, apo duhet të dihet, që është angazhuar në veprime të paligjshme apo vepra të tjera joetike
 - Të gjitha sa më sipër**
14. Cili është synimi i një vlerësimi të rrezikshmërisë së mashtrimit?
- Të ndihmojë organizatën të identifikojë se ku është më e cenueshme ndaj mashtrimit**
 - Të nxjerrë një vlerësim të përafërt të humbjeve të organizatës nga mashtrimi
 - Të vlerësojë dizajnin dhe efektshmërinë e kontroleve të brendshme të organizatës kundrejt raportimit financiar
 - Të përcaktojë fajësinë apo pafajësinë e punëtorit të dyshuar për mashtrim
15. Tregues të dobisë së Vlerësimit të rrezikshmërisë së mashtrimit (e VRM-së) janë:
- Identifikimi ku është cenueshmëria, si dhe aktivitetet që e rrisin rrezikun
 - Hartimi i planeve strategjike dhe taktike për zbutje të rreziqeve
 - Projektimi i teknikave për hetim të mashtrimit
 - Të gjitha sa më sipër**
16. Cila nga këto në vijim zakonisht konsiderohet si burimi më i dobishëm i informacionit financiar në dispozicion për hetuesit e mashtrimit për gjurmimin e qëllimeve?
- Pasqyrat financiare
 - Të dhënat bankare**
 - Deklarimi i taksave
 - Asnjëra nga më lartë
17. Cila nga këto në vijim është shembull i një metode indirekte e lokalizmit të pasurive apo gjurmimit të fondeve të paligjshme?
- Analiza e korrelacionit
 - Analiza e vlerës neto**
 - Metoda e zërave të veçantë
 - Të gjitha nga më lartë

18. Kur ndodh mashtrimi i menaxhimit, kompanitë zakonisht:
- Nënvlerësojnë pasuritë dhe të ardhurat neto.
 - Mbivlerësojnë pasuritë dhe nënvlerësojnë të ardhurat neto.
 - Mbivlerësojnë pasuritë dhe të ardhurat neto.**
 - Nënvlerësojnë pasuritë dhe mbivlerësojnë të ardhurat neto.
19. "Përmirësimi i komunikimit dhe vetëdijes për mashtrimin", si një prej dobive të Vlerësimi i rrezikshmërisë së mashtrimit duhet të nënkuptohet si:
- Mënyrë që ndihmon në të fokusuarit tek rreziqet e mëdha
 - Teknikë që mund të ulë racionalizimin e mashtruesit të mundshëm**
 - Përafrimi mes palëve të përfshira dhe orientimi i veprimeve
 - Pengese ndaj mashtruesit potencialë, duke përforcuar perceptimin e zbulimit
20. Cilat nga këto ne vijim përfaqësojnë njërën nga shtyllat e trekëndëshit të mashtrimit?
- Pranimi i heshtur i perceptuar
 - Burimet financiare të menjëhershme
 - Racionalizimi**
 - Asnjëra nga më lartë
21. Cila nga procedurat e mëposhtme NUK do të ishte e dobishme në parandalimin dhe zbulimin skemave mashtruese në shitje:
- Përgatitja e përmbledhjes së shitjeve neto për secilin punonjës dhe identifikimi i punonjësve me shitjet më të ulëta
 - Krahasimi i regjistrimit të parasë së gatshme me gjendjen fizike dhe kontrolli për mospërputhje**
 - Kritja e masave të sigurisë fizike të dalje të punonjësve
 - Ofrimi i zbritjeve për klientët të cilët nuk marrin faturat për blerjet e tyre
22. Cila prej me poshte klasifikohet si rrezik mashtrimi në raportimin financiar:
- Përvetësimi i fshehtë i aseteve**
 - Ndihma apo nxitja e mashtrimit nga palë të jashtme (konsumatorë, furnitorë)
 - Pagesa e mitos apo favoreve për kompani
 - Asnjëra nga më lartë
23. Cilat raporte do të konsideronit flamuj të kuq
- ↓Të Ardhurat me ↓Të arkëtueshmet
 - ↓Të ardhurat me ↓Elemente të rrjedha së keshit
 - ↑Inventari me ↑Të pagueshmet
 - ↑Të Ardhurat me ↓Inventari**
24. Cila prej më poshtë klasifikohet si rrezik mashtrimi në korrupsion:
- Shuma të pasqyruara gabimisht në bilanc të gjendjes, duke përfshirë rezervat
 - Konflikti i interesave dhe manipulimi me informata të brendshme
 - Përvetësimi i fshehtë i aseteve
 - Pagesa e mitos apo favoreve për zyrtarë publikë**

25. Metodrat që kompanitë përdorin për të fshehur pagesat e rryshfeteve dhe / ose rryshfetet për të mundësuar mbi/nën faturime përfshijnë të gjitha të mëposhtme përveç:
- A. të punësuar fantazmë
 - B. skema pagesa të mbifaturuara (skemat overbilling)
 - C. zvogëlimin e stokut**
 - D. të pagueshmet fiktive
26. Cila prej renditjeve të mëposhtme është e duhura në kornizën COSO
- A. Identifikimi i ngjarjeve, Vlerësimi i rrezikshmërisë, Aktivitetet e kontrollit**
 - B. Vlerësimi i rrezikshmërisë, Reagimi ndaj rreziqeve, Informimi dhe komunikimi
 - C. Mjedisi i brendshëm, Identifikimi i ngjarjeve, Vlerësimi i rrezikshmërisë
 - D. Identifikimi i ngjarjeve, Mjedisi i brendshëm, Reagimi ndaj rreziqeve
27. COSO sugjeron se _____ duhet të jenë përgjegjës për mjedisin e kontrollit organizatës.
- A. Udhëheqësit e departamentit
 - B. Punonjësit individual
 - C. Menaxhmenti i lartë**
 - D. Menaxhmenti i mesëm
28. Auditorët e brendshëm mund të jenë përgjegjës për:
- A. Përmirësimin e efektshmërisë së proceseve të menaxhimit, kontrollit të rreziqeve dhe qeverisjes në organizatë.
 - B. Drejtimit dhe kontrollit të aktiviteteve ditore
 - C. Hetimin e dyshimeve për mashtrim**
 - D. Asnjëra nga më lartë
29. Faton e ka njohurinë e duhur mbi kontrollet e brendshme dhe di që ato janë të rëndësishme. Kompania është përmirësuar, por ende ka probleme në fusha të caktuara. Nga vlerësimi I rrezikut, ai merr këto rezultate:
- I. Monitorim i paefektshëm i menaxhmentit të lartë
 - III. Ndarje e duhur e detyrave
 - IV. Kontrole të forta të brendshme
 - IV. Menaxhmenti i mesëm është indiferent
- Cilat janë fushat ku duhet të fokusohet Faton me qëllim zvogëlimin e mundësisë për mashtrim:
- A. I, II dhe III
 - B. I dhe II
 - C. I dhe IV**
 - D. II dhe IV
30. Cilat nga këto në vijim NUK konsiderohet si pjesë e politikës proaktive të mashtrimit?
- A. Marrja në pyetje për vlerësimin e mashtrimit
 - B. Vendet vakante mandatore të zbatuara me forcë
 - C. Auditimet e befasishme
 - D. Shfrytëzimi i paket i rishikimit analitik**

31. Cila nga këto NUK do të konsiderohet si një konflikt interesi?
- A. Një punonjës i cili ka një interes të pazbuluar ekonomik në një transaksion që ndikon negativisht punëdhënësin e tij
 - B. Një punonjës i cili ka një interes të pazbuluar në një transaksion dhe që vepron në mënyrë të dëmshme për kompaninë e tij në mënyrë që të përfitojë një i afërm, por jo vete punonjesi.
 - C. Një punonjës i cili ka një interes personal të zbuluar, por që nuk është ekonomike. Interesi i tij është në një transaksion që nuk ndikon negativisht punëdhënësin e tij.**
 - D. Të gjitha më lart
32. Sipas "Shkallës së mashtrimit," mashtrimi profesional mund të ndodh më shumë kur:
- A. Mundësitë e pranuar janë të larta
 - B. Presionet e situatës janë të larta
 - C. Integriteti personal është i ultë
 - D. Të gjitha nga më lartë**
33. Nga llogaria bankare e XYZ. Co., mungojnë fondet. Hetuesi i mashtrimit i caktuar për rastin fillon të mendojë: "Kush ka pas mundësinë dhe motivin që t'i shtijë në dorë këto të holla?" Mbase pa dashje, hetuesi i mashtrimit po e performon analizën _____.
- A. Kategorike
 - B. Empirike
 - C. Teoricien
 - D. Bihavioriste**
34. Ndërsa një objektiv i ekzaminuesit të mashtrimit është të përcaktojë nëse ka ndodhur mashtrimi dhe kush ka mundësi të jetë përgjegjës, qëllimi i ekzaminuesit të forenzikes financiare është:
- A. Të llogarit ndikimin financiar në bazë të supozimeve;
 - B. Të përcaktojë nëse pretendimet janë të arsyeshme në bazë të provave financiare dhe nëse po, ndikimin financiar të akuzave.**
 - C. Të mbledhë provat e nevojshme financiare dhe jofinanciare për të shqyrtuar në mënyrë të pavarur akuzat dhe për të përcaktuar ndikimin e tyre financiar.
 - D. Të përpiqet të mbledhë dëshmi të mjaftueshme për të mbështetur ose hedhur poshtë pretendimet dhe dëmet që lidhen me to.
35. Cila nga të mëposhtmet është një shembull i konfliktit të interesit?
- A. Një punonjës i cili ka një interes të fshehtë në një transaksion; por punonjési nuk vepron në një mënyrë të dëmshme për kompaninë e tij
 - B. Një punonjës i cili ka një interes të zbuluar ekonomik apo personal në një transaksion që nuk ndikon negativisht punëdhënësin e tij
 - C. Një punonjës që blen furnizime nga kompania e bashkëshortes**
 - D. Punësim pas 10 vitesh me ish-kontraktorin

36. Cila nga këto është e vërtetë në lidhje me shkallën e mashtrimit të përshkruar në tekstin si vijon:
- A. Sa më e ulët të jetë mundësia e perceptuar për të kryer mashtrime, aq më shumë racionalizim ka për të kryer mashtrime.
 - B. Sa më i ndershëm është një person, aq më i ulët është nevoja për të racionalizuar veprimin e mashtrimit.**
 - C. Kur rritet presioni financiar, edhe mundësia e perceptuar e ulët është e mjaftueshme për të kryer mashtrime.
 - D. Ndërsa 'nevoja' për të rritur lojrat e fatit, racionalizimi për të kryer mashtrime bëhet më i lehtë.
37. Standardi ndërkombëtar i Auditimit (ISA) 240, Përgjegjësia e Auditorit merr parasysh mashtrimin brenda auditimit të pasqyrave financiare sipas elementit:
- A. Rreziku i keqparaqitjes materiale për shkak të mashtrimit, duke përfshirë mashtrimin nga menaxhmenti**
 - B. Siguria absolute që pasqyra financiare nuk ka keqparaqitje materiale
 - C. Reagimi pasiv ndaj mashtrimit të identifikuar apo të dyshuar
 - D. Të gjitha nga më lartë
38. Hetuesit e certifikuar të mashtrimeve *zakonisht angazhohen pasi të ketë dyshime të mjaftueshme dhe:*
- A. Mund të ndihmojnë në zgjidhjen e pohimeve të mashtrimit, që nga fillimi e deri në përmbyllje
 - B. Bejne grumbullimin e provave
 - C. Mund të dëshmojnë ndaj gjetjeve
 - D. Të gjitha nga më lartë**
39. Përgjithësisht, mashtrimi është i mundshëm nëse të tre elementet janë të pranishme me bollëk, por mashtrimi mund të mos ndodhë kur presioni është i ulët dhe mundësia e ulët.
- A. E vërtetë**
 - B. E gabuar
40. Parandalimi i mashtrimit fillon:
- a. Me kontrollet e brendshme të punëdhënësit.
 - b. Në mendjen e punonjësit.**
 - c. Me ekzaminimin e mashtrimit.
 - d. Me veprime rregullatore dhe ligjore
41. B bleu një makinë të përdorur nga A, i cili siguroi B se makina do të siguronte "vite të tëra përdorimi". Një javë pasi B bleu makinën, motori u prish. A ka kryer një keqinterpretim mashtrues.
- A. E vërtetë
 - B. E gabuar**

42. Dëshmia relevante është dëshmi e cila ka të bëjë me një rast që tenton të vërtetojë ose hedh poshtë një fakt dhe gjithmonë pranohet në këtë rast

- A. E vërtetë
- B. E gabuar**

43. Cila nga këto është modeli i saktë i kontabilitetit?

- A. Pasuritë + Detyrimet = Kapitali I Pronarëve
- B. Pasuritë = Detyrimet - kapitalin e pronarëve
- C. Pasuritë = Detyrimet + kapitali pronarëve**
- D. Asnjë nga më lartë

44. Mashtrimi në pasqyrat financiare zakonisht merr formën e ekzagjerimit:

- I. aktiveve ose të ardhurave
- II. detyrimet dhe shpenzime

- A. I vetëm
- B. Të dy I dhe II**
- C. II vetëm
- D. As I e as II

45. Metoda e vlerës neto është efektive:

- A. Si provë në gjykatë.
- B. Për të nxjerrë rrëfimin e fajit.
- C. Për të mbajtur intervistat e të dyshuarve.
- D. Të gjitha si më lart.**

46. Ka tradicionalisht dy metodat e analizës së përqindjes së pasqyrave financiare Ato janë:

- I. Analiza drejtuar
- II. Analiza horizontale
- III. Analiza vertikale
- IV. Analiza diagonal

- A. I dhe II
- B. I dhe IV
- C. C. III dhe IV
- D. II dhe III**

47. Cila nga llojet e mëposhtme të pyetjeve duhet të përdorë gjerësisht intervistuesi gjatë fazës së informacionit të intervistës?

- A. Çështjet kryesore
- B. Pyetje të hapura**
- C. Pyetjet negative
- D. Pyetjet e mbyllura

48. Shkumbin, një Examinues i Certifikuar i Mashtrimeve, sapo ka filluar një intervistë me Drin. Pas prezantimit të tij dhe vendosjes së raportit me Drin, çfarë duhet të bëjë Shkumbin më pas?

- A. Përcaktimi i temës së intervistës**
- B. Filloni të bëni pyetje
- C. Vendosja e një deklaratë kalimtare
- D. Asnjë nga të mësipërmet

49. Në shumicën e rasteve të intervistës, disa pengesa sociale-psikologjike do të pengojnë komunikimin ndërmjet intervistuesit dhe të intervistuarit. Një pengesë e tillë është , që i referohet tendencës së të anketuarit për të ngatërruar rendin e përvojave.

- A. Hutimi kronologjik**
- B. Konfuzioni i pavetëdijshëm
- C. Konfuzioni i drejtpërdrejtë
- D. Asnjë nga të mësipërmet

50. Marrja në pyetje e punonjësve rreth aktiviteteve të mundshme mashtruese mund të jetë një metodë efektive për zbulimin e mashtrimit brenda një organizate.

- A. E vërtetë
- B. E gabuar**